



Tiranë, më 07.11. 2024, nr. 808 prot.

Tiranë, më 07.11. 2024, nr. 150f prot.

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
NDËRMJET
UNIVERSITETIT TË ARTVE
DHE
UNIVERSITETIT EUROPIAN TË TIRANËS**

Neni 1

Përcaktimi i Palëve

Palët në këtë Marrëveshje janë:

- 1. Universiteti i Arteve (UART)**, me adresë: *sheshi Nënë Tereza, Nr. 2, Tiranë*, i përfaqësuar nga Rektori, Prof. Dr. Erald Bakalli;
- 2. Universiteti Europian (UET) i Tiranës** me adresë: *Kompleksi Xhura, Rruga Xhanfize Keko, Tiranë 1000*, e përfaqësuar nga Rektori, Prof. Dr. Drita Kruja.

Neni 2

Qëllimi

Marrëveshja ka për qëllim rregullimin e bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet Palëve, si dhe ndërmjet strukturave përbërëse të tyre; përcaktimin e prioriteteve themelore të bashkëpunimit dhe mënyrën e zbatimit të tyre, mbështetur në legjislacionin në fuqi e në parime të gjithë pranuar dhe në interesa të përbashkëta.

Neni 3

Parime bazë

Parim themelor rregullues për bashkëpunimin e *Palëve* është liria akademike dhe autonomia universitare. Ato bashkëpunojnë duke respektuar njëra-tjetrën në vetëveprimin e tyre të rregulluar me ligje dhe me akte nënligjore, duke ruajtur dhe zhvilluar traditat më të suksesshme, përmes nismash, projektsh dhe veprimtarish të përbashkëta akademike e artistike kërkimore-shkencore. Në veprimtaritë e përbashkëta dhe jashtë tyre *Palët* pranojnë dhe respektojnë Kodin Evropian të sjelljes për integritet në kërkimin shkencor. Ato mbajnë qëndrim kritik dhe të papajtueshëm ndaj të gjitha formave të plagjiaturës dhe pseudoshkencës.

Neni 4

Drejtimet kryesore të bashkëpunimit

Bashkëpunimi ndërmjet *Palëve* shtrihet në gjithë fushat e dijes, me përparësi fushat me interes të përbashkët.

- *Palët* bashkëpunojnë për zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta shkencore, si: kuvende, kongrese, konferenca, forume, simpoziume, etj.
- *Palët* bashkëpunojnë për kryerjen e studimeve të përbashkëta.
- *Palët* bashkëpunojnë për aplikimin dhe zbatimin e projekteve të përbashkëta artistike shkencore vendore, rajonale dhe evropiane.
- *Palët* bashkëpunojnë për nxitjen dhe promovimin e studiuesve të rinj në fushën e artit dhe kulturës.
- *Palët* bashkëpunojnë për hartimin e strategjive të zhvillimit dhe të akteve normative në zbatim të tyre, në fushën e artit dhe kulturës.
- *Palët* bashkëpunojnë në shkëmbimet reciproke të pedagogëve dhe studentëve sipas programeve të studimit.

Neni 5

Bashkëpunime të veçanta

- Anëtarë të njësive bazë, njësive kryesore dhe anëtarë të Senatit Akademik të dy institucioneve marrin pjesë në aktivitete me interes të përbashkët, në zgjerim të traditave të mirënjohura të bashkëpunimit, siç parashikohet në Ligj dhe në Statutin përkatës të institucionit.
- Institucionet garantojnë përfshirjen e ekspertëve sipas fushave në njësitë e reja të kërkimit artistik shkencor ngritur pranë tyre. Institucionet rekomandojnë e propozojnë përfshirjen e ekspertëve më cilësorë, ato bashkëpunojnë në drejtimin e realizimit e veprimtarisë së tyre.
- Institucionet ftojnë përfaqësues të tyre të marrin pjesë si anëtarë jurie, vlerësues të jashtëm, recensues dhe oponentë në organizimin dhe zhvillimin e konkurseve shkencore për çmimet kombëtare vjetore të shpallura prej tyre, në të gjitha fazat e tyre.
- Përfaqësues nga të dy institucionet marrin pjesë në mënyrë reciproke në organizma, ose struktura që funksionojnë pranë këtyre institucioneve, sipas një marrëveshjeje paraprake dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- UART dhe UET ofrohen për bashkëpunim për hartimin e programeve të veçanta të studimeve universitare për ciklin e dytë të studimit master dhe ciklin e tretë të studimit doktoratë, si dhe për drejtimin shkencor të tyre.
- UART dhe UET mundësojnë zhvillimin e praktikave mësimore të studentëve pranë njësive të tyre sipas fushave të studimit.
- UART dhe UET në përputhje me aktet rregullatore mundësojnë publikimin e artikujve shkencor në revistat shkencore përkatëse.

Neni 6

Shkëmbimi i botimeve dhe i informacionit

- Palët i sigurojnë njëra-tjetrës shkëmbimin e ndërsjellë dhe të pakushtëzuar të informacionit artistik shkencor, të periodikëve që botojnë, të studimeve dhe monografive. Ato u dhurojnë periodikisht koleksione të botimeve të tyre bibliotekave përkatëse.
- Palët shkëmbejnë ekspertiza dhe mbikëqyrje të përbashkëta të veprimtarive artistike shkencore.

Neni 7

Zbatimi dhe kohëzgjatja

Kjo Marrëveshje do të zbatohet për të gjithë periudhën duke filluar nga data e nënshkrimit e në vijim.

Marrëveshja rinovohet çdo vit në heshtje dhe zgjidhet vetëm me marrëveshje me shkrim ndërmjet palëve.

Neni 8

Protokollet e bashkëpunimit

Me vullnetin e *Palëve* kësaj Marrëveshjeje i bashkëlidhen protokolle bashkëpunimi me afate realizimi që përcaktohen me diskutim mes tyre. Protokolle mund të nënshkruhen dhe për një veprimtari të vetme ose nene të veçanta të kësaj marrëveshjeje.

Neni 9

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Kjo Marrëveshje është çështje dypalëshe. Për paqartësitë dhe ankesat e mundshme *Palët* nuk kërkojnë apelim në ndonjë instancë tjetër. Mosmarrëveshjet midis *Palëve* zgjidhen me bisedime dhe mirëkuptim ndërmjet tyre. Në rast të mosarritjes së dakordësisë me bisedime për një periudhë dyvjeçare për çështje të diskutueshme, kjo Marrëveshje e humbet fuqinë.

Neni 10

Të fundme

- Të gjitha njoftimet dhe komunikimet që realizohen në kuadër të Marrëveshjes, bëhen me shkrim dhe dërgohen në adresën e mëposhtme, ose në adresa të tjera, të përcaktuara nga *Palët* herë pas here. Njoftimet do të dërgohen dorazi (përfshirë me shërbim me korrier brenda 24 orësh), ose përmes shërbimit postar ekspres të certifikuar, ku të gjithë pagesat dhe tarifat postare parapaguhën nga pala që dërgon njoftimin me shkrim, dhe njoftimet i drejtohen:

Për UART:

Person Kontakti: **Z. Ermir Hoxha**, Përgjegjës i Departamentit të Arteve të Aplikuara

Adresa: Sheshi Nënë Tereza, Nr. 2, Tiranë

E-mail: ermirhoxha@yahoo.com

Për UET:

Person Kontakti: **Z. Ermir Nika**, Përgjegjës i Departamentit të Arteve të Aplikuara

Adresa: Kompleksi Xhura, Rruga Xhanfize Keko, Tiranë 1000

E-mail: ermir.nika@uet.edu.al

- Kjo Marrëveshje nënshkruhet në dy kopje, të dyja në gjuhën shqipe, një për secilën Palë, me vlerë të barabartë.


Për:

Për:

UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTOR
Prof. Dr. Erald Bakalli



UNIVERSITETIN EUROPIAN TË TIRANËS
REKTOR
Prof. Dr. Drita Kruja



Tiranë më datë 07.11.2024